

Data 01.11.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Ndërtimi i rrugës Argjinatura nga Kryqëzimi i rrugës Berisha me rrugën Besëlidhje (Albavija) deri tek rruga Dajti”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 45233120-6 - Punime ndërtimi për rrugë

Afati i realizimit të punimeve është **88(tetëdhjetë e pesë) ditë pune**, sipas grafikut të punimeve. Garancia per mbulimin te difekteve ,që mund te lindin gjatë shfrytëzimit të objektit , nga ana e firmës të jetë 2 vjet .

VLERA E FONDIT LIMIT: 54,389,491 (pesëdhjetë e katër milion e treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

Argumentimi : Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës është referuar në preventivin e përlllogaritur mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Kamëz**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “ç” (sipas Shtojces 1 te DST).

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formulari i ofertes sipas Shtojce 1

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: Sipas Shtojcës 7 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të çertifikuara të bilanceve të **3 (tre)** viteve të fundit (**2019, 2020, 2021**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika “c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar*” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar*” (i ndryshuar).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe*

të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore për vitet (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo mëe vogël se vlera e parashikuar të kontratës që po prokurohet pa TVSH. *(Kjo kërkesë dotë konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar për vitin 2022 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kamëz, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **40%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, **kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të permbushë këtë kusht.** Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit **në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim**

2.3.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular Vlerësimi per realizimin e punimeve shoqeruar me:
- Kontrate Sipermarrjeje
- Situacion Perfundimtar
- Certifikaten e marrjes ne dorezim te perkohshme ose te perhershme
- Aktin e Kolaudimit
- Faturat Tatimore

b) Per kontrata te realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin e meposhtem:

- Vertetim leshuar nga subjekti privat shoqeruar me:
- Kontrate Sipermarrjeje
- Situacion Perfundimtar
- Aktin e Kolaudimit
- Faturat Tatimore

Shënim: Vertetimi duhet te percaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes se punëve, dhe faktin nëse kontrata eshte realizuar me sukses.



Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

Përvojë e sukseshme në realizimin e të paktën:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë **jo me te vogel** se **40%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.
- b) Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë sëbashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë **jo me te vogel** se sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikava (1.2), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj eshte hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një*

objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

Njesia e Prokurimit argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, është konstatuar se Komisionet e Vlerësimit të Ofertave kanë hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejtë të përvojës së ngjashme, në rastet kur në formularet e vlerësimit nuk përcaktohen % e pjesëmarrjes të secilit operator bashkim, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve), për rrjedhojë është e domosdoshme që Operatorët Ekonomik kur paraqesin kontrata të ngjashme, ku janë pjesë e një bashkimi operatorësh duhet të paraqesin gjithashtu dhe marrëveshjen e bashkëpunimit dhe prokurën e posaçme ku të përcaktohen % përkatëse.

2.3.2 Operatorët ekonomike duhet të paraqesin licensën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”.

Nr.	Pika e Licenses	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1- A	Punime germimi në tokë
2	NP-4- C	Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
3	NP-7- A	Ujësjetlla, gazsjetlla, vajsjetlla, vepra kullimi e vaditje
4	NP-12- A	Punime të inxhinierisë së mjedisit
5	NS-1- A	Punime për prishjen e ndertimeve
7	NS-18- A	Punime topogjeodezike

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive					
NP-1 A	Punime germimi ne toke	<table border="1"> <tr> <td style="text-align: center;"><u>Kategoria Punimeve</u></td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;"><i>Punime Germimi</i></td> </tr> </table>	<u>Kategoria Punimeve</u>	<i>Punime Germimi</i>	<p>0-20 milion</p> <p>Vlera e parashikuar ne preventiv per kete kategori punimesh eshte rreth 725,912 leke</p>			
<u>Kategoria Punimeve</u>								
<i>Punime Germimi</i>								
NP-4 C	Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.	<table border="1"> <tr> <td style="text-align: center;"><u>Kategoria Punimeve</u></td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;"><i>Punime per rruge</i></td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;"><i>Punime trotuare</i></td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;"><i>Punime Shtresash</i></td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;"><i>Punime te Ndryshme</i></td> </tr> </table>	<u>Kategoria Punimeve</u>	<i>Punime per rruge</i>	<i>Punime trotuare</i>	<i>Punime Shtresash</i>	<i>Punime te Ndryshme</i>	<p>20-50 milion</p> <p>Vlera e parashikuar ne preventiv per kete kategori punimesh eshte rreth 54,389,491 leke pa tvsh</p>
<u>Kategoria Punimeve</u>								
<i>Punime per rruge</i>								
<i>Punime trotuare</i>								
<i>Punime Shtresash</i>								
<i>Punime te Ndryshme</i>								
NP-7 A	(Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje)	<table border="1"> <tr> <td style="text-align: center;"><u>Kategoria Punimeve</u></td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;"><i>Punime KUB</i></td> </tr> </table>	<u>Kategoria Punimeve</u>	<i>Punime KUB</i>	<p>0-20 milion</p> <p>Vlera e parashikuar ne preventiv per kete kategori punimesh eshte rreth 10,893,566 Leke</p>			
<u>Kategoria Punimeve</u>								
<i>Punime KUB</i>								
NP-11 A	Ndertime per N/stacionet,kabinat e transformatoreve linja TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise	<table border="1"> <tr> <td style="text-align: center;"><u>Kategoria Punimeve</u></td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;"><i>Spostim Shtylla, elektrike</i></td> </tr> </table>	<u>Kategoria Punimeve</u>	<i>Spostim Shtylla, elektrike</i>	<p>0-20 milion</p> <p>Vlera e parashikuar ne preventiv per kete kategori punimesh eshte rreth 175,000 Leke</p>			
<u>Kategoria Punimeve</u>								
<i>Spostim Shtylla, elektrike</i>								
NP-12 A	Punime te Inxhinierise Mjedisore	<table border="1"> <tr> <td style="text-align: center;"><u>Kategoria Punimeve</u></td> </tr> </table>	<u>Kategoria Punimeve</u>	<p>0-20 milion</p>				
<u>Kategoria Punimeve</u>								

		<i>Punime Gjelberimi</i>	Vlera e parashikuar ne preventiv per kete kategori punimesh 136,040 Leke
NS-1A	Punime per prishjen e ndertimeve	<i><u>Punime per prishjen e ndertimeve</u></i>	0-20 milion Vlera e parashikuar ne preventiv per kete kategori punimesh eshte rreth 256,430 Leke
NS-18 A	Punime Topogjeodozike	<u>Kategoria Punimeve</u> <i>Punime topografike ne matje dhe rilevime per realizimin e objektit I dhe kerkohet anagazhim me pajisje dhe staf te specializuar per realizimin e rilevimeve topografike</i>	

NP-1 A *Punime germimi ne toke*

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gërmime në tokë, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-4 C (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale)

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me ndërtimin e rruges, është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për keto punime , të cilat bëjnë pjesë në kategorinë rrugë.

NP– 7 A (Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punime ne rrjetin e kanalizimeve, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP– 11 A (Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punime që lidhen me punime per ndertimin e ndriçimit rrugor, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP– 12 A *Punime të inxhinierisë së mjedisit.*

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punime që lidhen me punime per mbjellje peme decorative , ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses

NS-1- A (Punime per prishjen e ndertimeve)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punime që lidhen me punime per prishje ndertimi , ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses

NS-18A (Punime topogjeodezike)

Duke qene se në projekt e preventiv janë parashikuar punime të natyrës topogjeodezike (Matjet, piketimi, punimet ne trupin e rruges është e nevojshme zotërimi i kësaj pike license.

Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licensë III.2.B per “Grumbullim, dhe transportim i mbetjeve inerte dhe urbane jo te rrezikshme”,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligji nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe në VKM nr. 538 datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullimeve të tjera nënligjore të përbashkëta” të ndryshuar.

Operatori ekonomik fitues gjatë fazës së zbatimit të punimeve duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë, për këtë qëllim subjekti duhet të jetë i licensuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga ky i fundit për raportimin pranë autoritetit kontraktues.

Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes së mjedisit në punë dhe dokumentat përkatëse të operatoreve i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik per realizimin e punimeve duhet te disponoje fuqi punetore minimalisht **60 (gjashtedhjete)** persona. Per permbushjen e ketij kriteri, operatori ekonomik duhet te vetedkloroje disponimin e numrit minimal te punonjesve, per periudhen **Korrik 2022 – Shtator 2022**, ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojces 8.Ndersa operatori ekonomik fitues, para lidhjes se kontrates, duhet te dorezoje dokumentacionin si me poshte:

a. Vertetim të leshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Korrik 2022 – Shtator 2022**.

b. Listepagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Korrik 2022 – Shtator 2022**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vlerësimit të ofertave, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues për pikat 2.3.4/a dhe 2.3.4/b

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje **Korrik 2022 - Shtator 2022**, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim **te paktën 60 (gjashtedhjetë) personave duke përfshirë dhe stafin teknik**, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kater elementet e struktura se kosto (material, puntori, makineri, transport) zeri fuqi puntore ze rreth 20% te kosto.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, **drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

1 (nje) Inxhinier Ndertimi

1 (nje) Inxhinier Topograf/gjeodet

1 (nje) Inxhinier Hidroteknik

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit të ofertave, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë për inxhinieret e mesiperm: Kontratë pune e vlefshme, diplomë, Libreze pune dhe CV.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin staf inxhinierik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierit të ndërtimit, hidroteknik, elektrik, gjeodet, mjedisi, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.3, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.3.4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP - 1, NP - 4**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP - 7**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Hidroteknik**. Në këtë veper parashikohen nderhyrje të konsiderueshme në ndërtimin e impianteve sanitare dhe mbrojtjes nga zjarri.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS 18** është e nevojshme prezenca e një **Inxhinier Gjeodet/Topograf/**, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.
- *(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).*
- **2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **1 (një)** mjek të përgjithshëm të punësuar pranë shoqërisë ose të kontraktuar nga shoqëria. Për mjekun të paraqitet kontrata e punës ose kontraktimit, urdher mjeku dhe diploma perkatese. Kjo sipas Vendimit Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”.

Argumentimi: *AK argumenton se kërkesa për 1 (një) mjek të përgjithshëm është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në baze Vendimit Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”.*

2.3.7 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe punonjes të specializuar/kualifikuar si me poshte:

2 (dy)	Teknik Ndertimi
3 (tre)	Karpentier
3 (tre)	Pllakashtrues
4 (kater)	Hidraulik
2 (dy)	Hekurkthyes
2 (dy)	Kopshtare
5 (pese)	Shofere Kamioni
4 (kater)	Eskavatorist
3 (tre)	Automakinist

Për punonjesit e mësipërm të paraqiten kontratat e punës të vlefshme si dhe certifikata/diploma profesionale për secilin. Certifikatat/diplomat duhet të jenë të leshuara nga institucione publike/private të licensuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe

formimin profesional ne R.Sh.”dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente.

Punetoret e mesiperm te figurojne ne listepagesa per periudhen e kerkuar.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen,si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione te licensuara nga organet përkatëse, mbështetur ne Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare te Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Ne lidhje me 2 (dy) Teknik Ndertimi kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

Ne lidhje me 3 (tre)punonjes karpentier kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

Ne lidhje me 3 (tre) punonjes Pllakashtrues kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

Ne lidhje me 4 (kater)hidraulik kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

Ne lidhje me 2 (dy) punonjes hekurkthyes kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

Ne lidhje me 2 (dy) Kopshtare, kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike

5 (pese) Shofere Kamioni

4 (kater) Eskavatorist

3 (tre) Automakinist

Per manovratorët e mjeteve te renda si me siper te paraqitet kontrate pune e vlefshme, lejet e drejtimit per makinerite e renda sipas profesionit perkates dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente.

Per shoferet te paraqitet kontrate pune e vlefshme, lejet e drejtimit dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente.

Punetoret e mesiperm te figurojne ne listepagesa per periudhen e kerkuar. ***Në rastin kur punonjësit Manovrator ose shofer janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).***

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e kerkuar per punetoret e mesiperm.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar Manovrator me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Gjithashtu me qëllim nxitjen e garës është përcaktuar rasti përjashtimor ku për Manovratorët që janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmime të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë :

- a) eskavator gjermimi e ngarkimi dherash : të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për **Eskavatorist**;

automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti : autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për **Automakinist**

2.3.8 Operatori Ekonomik, per realizimin e kontrates, duhet te disponoje mjetet dhe pajisjet e meposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamione veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 25 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	3
2	Kamion me vinc	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
3	Kamioncina me kapacitet 3.5-5 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
4	Kamioncina me kapacitet 2-3 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	3
5	Fadrome me goma	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
6	Eskavator me zinxhir	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
7	Minieskavator	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
8	Autobetoniere	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
9	Autopompe Betoni	Ne pronesi ose me qera	Cope	1

10	Rimorkiator per transportimin e mjeteve te renda me kapacitet min 20 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
11	Asfaltoshtruese	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
12	Autobot Uji	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
13	Autobitumatrice	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
14	Grejder	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
15	Rrul ngjeshes gome - cilinder me kapacitet min 10 ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
16	Rrul asfalti cilinder - cilinder me kapacitet min 8 ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
17	Rrul asfalti cilinder - cilinder me kapacitet 4 - 8 ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
18	Stabilizues (Mixer) shtresash rrugore	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
19	Betoniere	Ne pronesi ose me qera	Cope	3
20	Vibrator Betoni	Ne pronesi ose me qera	Cope	3
21	Matrapik	Ne pronesi ose me qera	Cope	3
22	Cekick pneumatik	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
23	Tokmak elektrik	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
24	Depozita uji 5000 L	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
25	Fabrikë Betoni (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi	Copë	1
26	Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi	Copë	1
27	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi	Copë	1

Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 Per miratimin e rregullores “Per sigurine ne kantier” i ndryshuar, si më poshtë vijon:

- **Kokore minimumi 60 copë**
- **Jeleke Fosforeshente minimumi 60 copë**
- **Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë**
- **Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 10 copë**
- **Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë**

Kiteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit te ofertave përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (mjetet me goma), kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit:

-
- çertifikaten e pronesisë;
 - leja e qarkullimit;
 - çertifikaten e kontrollit teknik;
 - siguracionin;
 - leja e transportit që leshohet nga njesia vendore
 - fotot perkatëse ku të duket qartësisht targa dhe lloji i mjetit

Per mjetet që pajisen me çertifikaten e transportit për lende të rrezikshme, të paraqitet:

- çertifikaten e pronesisë;
- leja e qarkullimit;
- çertifikaten e kontrollit teknik;
- Siguracionin
- çertifikaten e transportit që leshohet nga njesia vendore për transport lëndesh të rrezikshme
- fotot perkatëse ku të duket qartësisht targa dhe lloji i mjetit

b) Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase e cila duhet të përfshijë objektin perkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e kohezgjatjes së objektit deri në përfundimin e plotë të punimeve.

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

d) Për Fabrikën e Betonit, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot ose fatura tatimore perkatëse, leja mjedisore leshuar nga QKL në rastet kur është në pronesi. Nëse për operatorët ekonomik që kanë kontrata furnizimi të paraqitet vetëm kontrata e furnizimi.

e) Për nyjen e inerteve duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot ose fatura tatimore perkatëse, leja mjedisore leshuar nga QKL në rastet kur është në pronesi. Nëse për operatorët ekonomik që kanë kontrata furnizimi të paraqitet vetëm kontrata e furnizimi.

f) Për Fabrikën e Asfaltit duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot ose fatura tatimore perkatëse, leja mjedisore leshuar nga QKL, Nëse për operatorët ekonomik që kanë kontrata furnizimi të paraqitet vetëm kontrata e furnizimi.

g) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedurë të shpallura fitues nga operatori ekonomik.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

- Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.
- Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit të ofertave përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: Kontratë pune e vlefshme, diplomë, urdher mjeku.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), specifikimet teknike të projektit, volumet e miratuara nga projektuesi.

Mjetet Fadrome, eskavator me zinxhir, minieskavator, janë kerkuar për realizimin e punimeve të gërmimit për shtresat e rruges.

Sipas preventivit, janë vendosur mjetet Rrula tonazhe të ndryshëm asfalti dhe ngjeshjeje, asfaltoshtruese, autobitumatrice, autobot uji, grejder, stabilizues shtresash rrugore për realizimin e punimeve të asfaltit, shtresave të cakullit dhe shtresave të tjera të rruges.

Fabrikat janë kerkuar si kriter për realizimin e punimeve në afat dhe me çilesi, konkretisht punimet e shtresave, asfaltit, betonimeve,

:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s’kualifikimi.

Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

2.3.9 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë

ISO 14001:2015 **Sistemet e Menaxhimit Mjedisor**
ISO 45001:2018 **Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë**
BS ISO 39001:2012 **Per sistemin e menaxhimit te sigurise ne trafikun rrugor**

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë. Çertifikatat e lëshuara nga organizma të pa akredituara do të konsiderohen kusht skualifikimi.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci

extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi **BS ISO 39001:2012** Kjo çertifikatë mundëson që kompanite të punojnë me sistemet e qarkullimit rrugor, të reduktojnë dhe të përjashtojnë rreziqet e humbjes të jetes dhe plagosjeve në lidhje me aksidentet gjatë procesit të punës.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (bordura betoni, pllaka betoni, tuba) Për materialet e kerkuara OE duhet të paraqesë katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe të paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në Specifikimet teknike.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, si dhe”, në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM–së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem Teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të verifikojë që specifikimet teknike të paisjeve të propozuara nga operatorët ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit , duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në Specifikimet teknike .

Shënim: *Ne lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit deshmues për kërkesat që përshihen në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, mbajme në konsideratë përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2 të këtij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese të ofertes, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikime teknike, projekti, preventivi, grafiku dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e mëposhteme:

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit